Viti shkollor 2011 - 2012

**PAKETA E GJELBËR TRANSMENTON NJOHURI,
ZHVILLON AFTËSITË,
KULTIVON VLERA,
PËR NJË TË ARDHME TË QËNDRUESHME**

Paketa e Gjelbër është një paketë materialesh të shumëllojshme për edukimin mjedisor, e konceptuar kryesisht për mësuesit dhe nxënësit e shkollave 9-vjeçare në Shqipëri, por ajo mund të përdoret dhe nga nivele të tjera arsimore. Ajo fokusohet, në mënyrë të veçantë, mbi aspektet e mbrojtjes së mjedisit dhe të zhvillimit të qëndrueshëm dhe përfshin një numër të madh materialesh edukative si: libri i mësuesit, së bashku me planin mësimor dhe fletët e punës për nxënësit; koleksioni me filma vizatimorë dhe edukativë; CD me informacion më të zgjeruar mbi temat mjedisore; si dhe lojën e dilemave.

Paketa e Gjelbër është një produkt në përputhje me standardet e programit mësimor të shkollës sonë me njohuri bashkëkohore të nivelit Evropian. Paketa e Gjelbër është e një cilësie shumë të lartë, për t'u përdorur me endje në shkollë dhe jashtë saj. Ajo është e para dhe i vetmi produkt, i cili vjen përpara nxënësit dhe mësuesit të shkollës sonë në formatin e shkruar dhe atë elektronik.

Paketa e Gjelbër formon vlera të reja tek nxënësit dhe ngre një model të ri sjellje në shkollë, shtëpi dhe shoqëri. Ajo nuk është thjesht një përmbledhje njohurish në fushat e mjedisit. Nxënësit janë partnerë me mësuesit në kryerjen e aktiviteteve të ndryshme, në diskutime dhe vendimmarrje. Mesazhet kryesore të kësaj pakete shpërndahen nëpërmjet nxënësve dhe mësuesve, në mënyrë shumë efektive, dhe tek anëtarët e tjerë të familjes dhe shoqërisë.

PAKETA E GJELBËR

**MATERIALE TË SHUMËLLOJSHME EDUKATIVE DHE BURIMORE
PËR EDUKIMIN MJEDISOR NË ORËT E LIRA LËNDORE
DHE/OSE PROGRAMIN EKSTRAKURRIKULAR**

QENDRA RAJONALE E MJEDISIT
Shqipëri

Rr. Ismail Qemali, No 27, Tirana, Shqipëri
P.O.Box 127, Tirana, Shqipëri
tel/fax: (+355 4) 2 23 29 28
e-mail: rec.albania@rec.org / druci@rec.org
Web: http://albania.rec.org

Materiale mbi Edukimin Mjedisor përgatitur nga REC Shqipëri

Udhëzues për mësuesit në realizimin e edukimit mjedisor jashtë mureve të shkollës

Ky është një udhëzues i thjeshtë për mësuesit e edukimit mjedisor në shkollat tona 9-vjeçare. Ky udhëzues ju rekomandon mësuesve veprimtari mjedisore që ata, me nxënësit e tyre, mund të realizojnë jashtë mureve të shkollës, më pranë natyrës. Ka shumë metoda të përdorura nga mësuesit e edukimit mjedisor, të cilat mund të ndihmojnë dhe ofrojnë zgjidhje në realizimin e veprimtarive mjedisore. REC mendon se, duke i ndarë këto ide përmes këtij manuali, mësuesit mund t'i përshtatin, zhvillojnë dhe zgjerojnë më tej ato. Veprimtaritë e këtij udhëzuesi janë fokusuar në katër fusha kryesore, në atë të ajrit, ujit, natyrës dhe mbetjeve.

Zbuluesi i thesareve të pyllit - një libërth lojë për nxënësit e ciklit fillor

Zbuluesi i thesareve të pyllit është libër mjedisor për nxënësit e ciklit fillor. Lexuesi është njëkohësisht dhe lojtari i kësaj loje mjedisore e cila e vë atë në rolin e një zbuluesi, eksploratori apo vëzhguesi të natyrës.
Nxënësit / lexuesit bëjnë një udhëtim imagjinar në një zonë natyrore, duke zbuluar bukuritë dhe rëndësinë e saj.
Loja, e cila fillon me një labirinth, fton fëmijët që, duke ndjekur të gjitha rregullat e saj, të mund të zbulojnë mesazhin mjedisor që autori ka për ta. Në fund të fundit të gjithë jemi dakort me thënien e Plutarkut që "Mendja **nuk** është një enë që duhet mbushur, **por** një zjarr që duhet ndezur."

DVD-ja e Filmit "Planeti Plastik"

"Planeti Plastik" është një film dokumentar, zbavitës dhe investigues, i cili tregon që plastika është bërë një kërcënim për njerëzit dhe për mjedisin.
Filmi "Planeti Plastik", me një udhëtim rreth botës, zbulon që tashmë bota jonë nuk ekziston dot pa produkte plastike, por në të njëjtën kohë problemet dhe rreziqet me të cilat po përballet ky planet janë të lidhura ngushtë me lëndën plastike. Në këtë film, autori, me shembuj mbresëlënës, intervista dhe takime interesante, demaskon botën e re plastike.
Nëse ju e shihni këtë film, ju nuk do të pini më kurrë nga një shishe plastike!
A e dini që vetëm 1% e prodhimit botëror të polistirenit riciklohet dhe që në gjakun e secilit nga ne mund të gjendet plastikë?

për më shumë vizitoni:

http://albania.rec.org
www.mjedisisot.info

QENDRA RAJONALE E MJEDISIT
Shqipëri